
KOMUNA E JEGUNOVCIT



FLETORJA ZYRTARE
E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Botohet sipas nevojës	**Numër 45**	**02.10.2024**

JEGUNOVC, TETOR 2024

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Planit operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025

Shpallet Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2024.

Nr. 09-1890/1
02.10.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi1 pika 15 kurse në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokal("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02),nenit 21 paragrafi1 pika12 dhe 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03) dhe nenit 61 dhe 64 të Vendimit për rendin botor në Komunën e Jegunovcit ("Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 38/07) ,Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e dyzetepestë të mbajtur më 30.09.2024, morri:

PLANI OPERATIV

për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025

Ky Plan operativ për mirëmbajtjen dimërore të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit është në pajtim me sendërtimin e kompetencave të komunës si edhe me realizimin e Programit për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit.

1. Mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale në territorin e Komunës së Jegunovcit përfshinë:

a.) Për pastrimin e drejtimeve të udhëve lokale:
- Udha lokale në f. Jegunovc e cila e lidh SHF.„Aleksandar Zdravkovski„ me udhën rajonale R-407;
-Nga udha rajonale R-407 deri te ura e lumit Vardar;
-Udha lokale Siriçinë-Tudencë - Kopanicë - Raotincë - Podbreg;
-Udha lokale Jegunovc-Raotincë (rrugica Çavkovska prej te urra deri te shtëpia e fundit);
-Prelubishtë - Tudencë;
-Udha lokale Prelubishtë - Zhillçë;
-Hekurudhë - Ratajë;
-Shemshovë - Ozormishtë (në gjatësi prej 850 m. respektivisht 100 m para shtëpisë së parë në f. Ozormishtë);
- Nga udha rajonale R-407 deri në fund të fshatit në f. Jançishtë në gjatësi prej 700 m.
- Pastrimi deri te shkollat, objektet fetare dhe varrezat nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit.

b.) Për pastrimin e drejtimeve të udhëve lokale :
-Nga udha rajonale deri te Qendra në f. Jazhincë dhe deri te shkolla e re periferike;
- Nga udha rajonale deri te shkolla periferike në f. Jazhincë (rruga e re e ndërtuar),
-Nga udha rajonale deri te Qendra e f.Rogaçevë, deri te Kallugjer dhe deri te fundi i fshatit;
-Nga udha rajonale deri te Qendra e f. Staro Sellë (ndër kishën);
- Udha periferike nga gurëthyesja Surin deri te kisha
-Nga udha rajonale deri te Qendra e f.Vratnicë;
-Nga udha rajonale deri te Qendra e f. Bellovishtë me krahun në drejtim të v.q. Strançinja; dhe deri te v.q. Petaçko Vodiçe
-Nga udha rajonale deri te varrezat e fshatit në f. Orashë;

- Nga udha rajonale me krah kah lagja e re deri te ambulanca e f.Vratnicë;
- Udhën lokale nga moteli f.Vratnicë deri në Bellovishtë;
-Nga Kisha e fshatit Jegunovc deri te Peshter.

2. Kushte për pastrimin

Udhët lokale të pastrohen në gjatësi prej më së paku 3 m me punimin e zgjerimeve për kalim të makinave në gjatësi prej më së paku 15 m dhe jo më larg se 200 m.

Kryerësi i punëve t'i angazhojë makinat për pastrimin e udhëve lokale kur trashësia e borës do të arrij 10 cm.

3. Kontrolli i kualitetit të punëve të kryera

Kontrollin e kualitetit të punëve të kryera do ta bëjë Komisioni për urbanizëm,veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor pranë Këshillit të Komunës së Jegunovcit.

Gjatë kryerjes së kontrollit komisionit t'i sigurohet makinë zyrtare nga komuna.

Në qoftë se Komisioni për urbanizëm,veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor vërteton se kryerësi i punëve nuk i kryen punët në pajtim me kontratën për mirëmbajtjen e rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit nuk do ti bëhet pagesa.

4. Për mirëmbajtjen dimërore dhe pastrimin e udhëve lokale në shënuara në pikën 1 nën a) dhe nën b) Komuna e Jegunovcit do të lidh kontratë me ofertuesin më të volitshëm.

5. Për pastrimin e rrugëve në vendbanimet në pajtim me Vendimin për rendin botor në Komunën e Jegunovcit nr. 07-1171/3 të dt. 09.07.2007, detyrim i Këshillave të Bashkësive lokale është që nëpërmjet qytetarëve t'i zbatojnë dispozitat nga neni 61 dhe 64 nga Vendimi i përmendur i cili thotë:

"Neni 61

Qytetarët e pastrojnë borën dhe akullin në sipërfaqet publike dhe të komunikacionit nëpër vendbanimet .

Veçanërisht duhet tu kushtohet kujdes hapësirave para oborrit të tij deri në mes të rrugës.

Neni 64

Personat juridik dhe fizik janë të obliguar që ta pastrojnë borën dhe akullin nga trotuaret ose nëse rruga nuk ka trotuare atëherë shiritin nga gjysma e rrugës në tërë gjatësinë e lokacionit para objektit të tij".

6. Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve dhe rrugëve lokale nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit, hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-1823/3
30.09.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc

Shpallet Vendimi për dhënie pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2024.

Nr. 09-1890/2
02.10.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e dyzetepestë të mbajtur më 30.09.2024 mori:

V E N D I M

për dhënie pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc

Neni 1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc nr. 08-491/3 të miratuar nga Këshilli i drejtues i IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc më datë 25.09.2024

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-1823/4
30.09.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc

Shpallet Vendimi për dhënie pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2024.

Nr. 09-1890/3
02.10.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e dyzetepestë të mbajtur më 2024 mori:

V E N D I M

për dhënie pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc

Neni 1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc nr. 08-491/4 të miratuar nga Këshilli i drejtues i IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit Jegunovc më datë 25.09.2024.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-1823/5
30.09.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 40 paragrafi 1,2 dhe 3 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për mos shpalljen e Vendimit nr. 08-1823/6 të datës 30.09.2024

1. Nuk shpallet Vendimi për shfrytëzim të përkohshëm të fushës së futbollit në f. Jegunovc për KF Hajduk Vratnicë nr. 08-1823/6 të datës 30.09.2024, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2024.

2. Vendimi nga paragrafi i mëparshëm i këtij Aktvendimi mos të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Arsyetim

Në pajtim me nenin 51 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) kryetari i komunës nuk e shpall Vendimin e shënuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi , për arsye se nuk ka të dorëzuar kërkesë nga KF Hajduk Vratnicë në të cilën do të arsyetohen shkaqet dhe kushtet për shfrytëzim të përkohshëm të fushës së futbollit në f. Jegunovc, si dhe Gjendje rrjedhëse nga Regjistri qendror.

Nr. 09-1890/1
02.10.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 24-a të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/15, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së",nr. 275/19 dhe 89/22) dhe neni 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .05/02) dhe të nenit 16 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc nr. 01-2/4 të datës 02.07.2021 kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 02.09.2024 mori:

A K T V E N D I M

për shkarkim të Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc

1. Aco Evkovski nga f. Raotincë me NVAQ 3001986470023 dhe numër të letërnjoftimit A1725552 të lëshuar nga MPB Tetovë shkarkohet nga Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc , përfundimisht me 02.09.2024 për arsye të përfundimit të mandatit.

2. Personi nga pika 1 e këtij Aktvendimi nr. 09-34/1 të datës 05.01.2024 ishte emëruar Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc për periudhë gjashtë mujore.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi përfundon të vlejë Aktvendimi nr. 09-34/1 të datës 05.01.2024

4. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e marrjes, dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Komuna e Jegunovcit
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v

Në bazë të nenit 24-a paragrafi 3 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/15, 64/18, 35/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së",nr. 275/19) dhe neni 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr .05/02) dhe të nenit 16 paragrafi 1 pika 3 të Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc nr. 01-2/4 të datës 02.07.2021, kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 03.09.2024 mori:

A K T V E N D I M

për emërimin e Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc

1. Lupço Stoleski nga f. Zhillçë me NVAQ 2707963470006 dhe numër të letërnjoftimit A2434933 të lëshuar nga MPB Tetovë, emërohet Ushtrues detyre Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc për periudhë nga 03.09.2024 deri 02.03.2025.

2. Ushtruesi i detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc do ti kryej punët deri në emërimin e drejtorit të ri por jo më gjatë se gjashtë muaj.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Komuna e Jegunovcit
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v

P ë r m b a j t j a

Aktvendimi për shpalljen e Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025;.....1
Plani operativ për mirëmbajtje dimërore të rrjetit të udhëve lokale dhe rrugëve nëpër vendbanimet e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024/2025;.....2

Aktvendimi për shpalljen e Vendim për dhënie pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc;.....4
Vendim për dhënie pëlqim Rregullores për organizimin e brendshëm të vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc;.....5

Aktvendimi për shpalljen e Vendim për dhënie pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc.....6
Vendim për dhënie pëlqim Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës të IPKKF MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc.....7

Aktvendimi për mos shpalljen e Vendimit nr. 08-1823/6 të datës 30.09.2024.....8

Aktvendimi për shkarkim të Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc 9

Aktvendimi për emërimin e Ushtruesit të detyrës Drejtor i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc,Jegunovc 10

Përmbajtja.....11